





Dialogu **Social** **2019**



Sfidat dhe mundësitë: **Ku jemi?**

Edhe pse në diskursin politik çështjet sociale kanë filluar të vijnë në shprehje më shumë këto vitet e fundit, ende mungojnë masa konkrete për të siguruar një sistem të mbrojtjes sociale. Dialogu mes të faktorëve kyç si qeveria, sindikatat dhe organizatat e punëdhënësve ende nuk është në nivelin e duhur, që mbetet edhe arsyeja e mos krijimit të një sistemi të mirëfilltë.



Trajnim për negocimin kolektiv, avokim dhe media social

Dialogu social është një nevojë e domosdoshme, por me zhvillimet që janë bërë deri më sot, ai përballet me probleme fundamentale, gjë që ndikon jo vetëm në aspektin social, por edhe në mënyrën dhe efikasitetin e qeverisjes në përgjithësi. Asnjë nga qeveritë e deritashme, dialogut social nuk i ka dhënë rëndësinë e duhur.

Në mënyrë që rezultati përfundimtar të jetë një sistem efektiv i mbrojtjes sociale, dialogu social duhet të jetë ndër prioritetet kryesore të qeverisë. Ky sistem duhet të jetë në rend të parë financiarisht i përballueshëm për një shoqëri në tranzicion, buxheti vjetor i të cilës arrin pak më shumë se dy miliardë euro. Ai duhet të jetë institucionalisht i menaxhueshëm, në mënyrë që mos të ndikohet nga mungesa e sundimit të ligjit, e që jo rrallë herë është paraqitur si sfidë në shumë procese. E fundit por jo më pak e rëndësishme, sistemi i mbrojtjes sociale duhet të jetë gjithëpërfshirës. Secili qytetar i vendit duhet të marrë shërbimet e tij në mënyrë të barabartë.



Hartimi i Planit Opeacional nga Inspektorati i Punës dhe BSPK-ja me mbështetje të IKS

Në vitin 2019 nga buxheti i Kosovës janë shpenzuar 29.6 milion euro vetëm për skemat e ndihmës sociale. Sipas parashikimeve, i njëjti buxhet pritet të tejkalojë 30 milion euro në dy vitet e ardhshme. Pavarësisht kësaj, varfëria në Kosovë nuk është zvogëluar. Përkundrazi, Kosova vazhdon të mbetet vendi i varfër me shkallën e papunësisë ndër më të lartat në Evropë, e për kategori të caktuara edhe në botë.



Takime me përfaqësues të bizneseve në pesë rajonet e Kosovës

Sipas raportit të Bankës Botërore, 29% e banorëve të Kosovës jetojnë në kufirin e varfërisë me më pak se 1.72 euro në ditë. Pjesët më të varfëra të shoqërisë janë personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, gratë, komunitet pakicë, veçanërisht komuniteti Romë, Ashkali dhe Egjiptas.



Dialogu social: problemet dhe sfidat – Prizren

Çështjet sociale vazhdojnë të mos jenë atraktive as për partitë politike, si mjet për të rritur mbështetjen për to, e as nga qytetarët si arsye për të përcaktuar votën e tyre. Kosova ka një mori skemash sociale, por nuk ka sistem të mbrojtjes sociale. E gjithë politika sociale duhet të rimodelohet, për t'i lehtësuar jetën e qytetarëve. Shërbimet shëndetësore nuk funksionojnë, për të përmendur këtu kujdesin e shëndetit terciar, i cili pothuajse është tërësisht jo funksional. Më të prekurit nga kjo situatë, janë të moshuarit, të cilëve nuk u ofrohet kujdesi i nevojshëm, përjashtojnë një pension bazë, i cili nuk përmbush as

nevojat elementare që një qytetar i kësaj kategorie i ka. Përgjithësisht, qytetarët përfitojnë shërbime të dobëta sociale, për të mos thënë se nuk ekzistojnë fare.

Si pasojë e kësaj, kanë filluar të shfaqen probleme të mëdha sociale, të atilla sa do nevojiten vite për t'u zgjidhur nëse qeveria nuk vepron që tash. Njëri prej tyre është migrimi i popullsisë. Vetëm në pesë vitet e fundit, mbi 170 mijë qytetarë kanë lëshuar vendin, bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Thënë ndryshe, përgjatë kësaj periudhe, një qytet Prizreni, i cili është i dyti më i madhi në vend pas Prishtinës, është boshatisur. Sipas hulumtimeve të IKS, ikja për vetë ata që e ndër marrin këtë hap, është

zgjidhja e fundit e preferuar. Nga mbi 1,200 persona të anketuar nëpër gjithë Kosovën, mbi 60% e tyre në mes të një pune në Kosovë dhe asaj në vendet e Bashkimit Evropian, do të zgjidhnin të parën.



IKS ka mbështetur vizitën studimore të anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në Lubjanë – Slloveni.



Hartimi i planit të punës nga organizatat partnere të Koalicionit për Dialog Social – 2 korrik 2019, Prishtinë.

Sistemi i mbrojtjes sociale është një nevojë e domosdoshme për qytetarët e Kosovës dhe mungesa e tij paraqet problem serioz. Si metodë e duhur për funksionimin e tij është dialogu social, proces në të cilin duhet të përfshihen të gjitha palët. Me qëllimin e ngritjes së nivelit të mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët, IKS ka mbështetur Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale si dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në shumë aktivitete edhe përgjatë vitit 2019. Nga përfshirja e IKS në to, është vërejtur se qasja e shpenzimit të parave në skema sociale, konkretisht në atë të ndihmës sociale, nuk është efikase. E aplikuar prej kohësh, kjo qasje ka dëshmuar se shpërndarja e parave pa një plan konkret është e

dëmshme edhe për stabilitetin financiar të shtetit dhe si e tillë nuk duhet të vazhdojë.

Zgjedhjet dhe Mirëqenia

Në dy palë zgjedhjet e fundit parlamentare në Kosovë, vëmendja e partive politike për politika sociale është rritur. Segmenti kryesor i mbrojtjes sociale që zë vend në premtimet e tyre për politika sociale është shëndetësia, dhe në përgjithësi ka filluar një përzjerje e qasjeve të majta të qeverisjes me ato të djathta që kanë dominuar këto dy dekadat e fundit.

Partia fituese e këtyre zgjedhjeve, Lëvizja Vetëvendosje ka premtuar një mori reformash të cilat do të çonin në drejtim të krijimit të një sistemi të mbrojtjes sociale. Në këtë proces, gara e zhvilluar mes pesë partive, PDK-së, Lëvizjes Vetëvendosje, LDK-së, Koalicionit AAK-PSD 100% shtet, dhe Koalicionit AKR – Nisma Social Demokrate, u mbyll me rezultate që në fund dëshmuuan nevojën dhe vetëdijësimin e qytetarëve për ndryshim. Këtu patjetër që ka ndikuar artikulimi i nevojës shoqërore nga qytetarët për ta transformuar mënyrën e qeverisjes që i kushton vëmendje më shumë aspekteve sociale.

Partia fituese, Lëvizja Vetëvendosje ka premtuar një mori masash që drejtpërdrejt prekin kategori të caktuara. Themelimi i fondit për sigurime sociale, mbështetja e prindërve përmes shtesave për fëmijët, çështja e banimit për çiftet e reja dhe gratë kryefamiljare, janë premtuar si veprime që do bëhen në kuadër të një politike sociale më të gjerë. Partia e dytë e dalë nga këto zgjedhje, LDK-ja, nga të gjitha elementet e një sistemi të mirëqenies sociale, shëndetësisë i ka kushtuar më shumë rëndësi. Funkcionalizimi i Shërbimit Informativ Shëndetësor, formimi i mekanizmave të inspektimeve të sektorit farmaceutik etj., janë disa nga elementet që e plotësojnë premtimin e tyre për shëndetësinë. Koalicioni AAK – PSD ka premtuar krijimin e fondit për sigurime shoqërore dhe heqjen e kufizimeve për familjet me asistencë sociale. Ndërsa në fund, kandidatët e PDK-së kanë premtuar deri në 100% rritje të ndihmave sociale. Kjo e fundit vazhdon traditën e premtimeve me përqindje të larta të skemave sociale. Njëjtë kishte ndodhur edhe në programin politik të saj për zgjedhjet e vitit 2017, premtim për rritje të çdo skeme sociale nga 25% çdo vit, gjë që është shumë pak realiste në kushtet e tanishme, por edhe nëse ndodh nuk nënkupton krijim të sistemit të mbrojtjes sociale.

Opozita si fituese e zgjedhjeve të 6 tetorit, ka bërë premtime të cilat kur i analizon në kombinim me vështirësitë e krijimit të qeverisë mes Lëvizjes Vetëvendosje dhe LDK-së, ka shumë pak gjasa që deri në fund të mandatit të qeverisë së ardhshme të ketë një sistem të mbrojtjes sociale të duhur. Ka një mori arsyes pse qeveria e Kosovës duhet të punojë në një drejtim të tillë. Në rend të parë, qytetarët duhet të kenë një shërbim social, jo vetëm që i bën



ata objekt të një trajtimi më të afërt të një politike të caktuar, por ju mundëson atyre një jetë të denjë si qytetarë të lirë dhe të barabartë. Edhe niveli i lartë i varfërisë, i përmendur më herët, duhet të jetë përgjegjësi që qeveria duhet adresuar. Përdërisa nuk ka zgjidhje se si të nxirren qytetarët nga varfëria, duhet të ekzistojë një mekanizëm i cili ua lehtëson varfërinë, sidomos në marrjen e shërbimeve publike.

Qeveria e ardhshme duhet të ketë si prioritet politikat sociale të cilat kanë në fokus kategori të caktuara të shoqërisë si njerëzit që jetojnë në varfëri, të moshuarit, gratë dhe lehonat. Qëllim i tyre duhet të jetë stabiliteti shoqëror i vendit, i cili tash për tash nuk ekziston dhe nga i cili rrezikohet që Kosova të thellohet në kriza edhe më të mëdha.

Siguria dhe Shëndeti në Punë

Për më shumë se 6 vjet, IKS monitoron sektorin privat për kushtet e punës në të cilat punojnë qytetarët. Që atëherë, ato nuk kanë pësuar përmirësime, përkundrazi në sektorë të caktuar siç është ai i ndërtimitarisë vetëm se janë përkeqësuar. Siguria në punë është një e dhënë në Kosovë, e cila para së gjithash dëshmon se shteti ligjor nuk funksionon në mënyrën e duhur. Katër mujori i parë i vitit 2019 ka shënuar plot 30 aksidente në vendin e punës. Vetëm deri në muajin maj, 5 punëtorë kanë humbur jetën në vendin e punës, ndërsa deri në muajin tetor numri ka shkuar në 14 viktime, shifër alarmante për një vend të vogël si Kosova. Marrë në shqyrtim edhe vitet paraprake, del se ritmi i këtyre vdekjeve nuk ka rënë aspak. Pjesa më e madhe e tyre i takojnë sektorit të ndërtimitarisë. Bazuar në mesataren e vdekjeve në 100 mijë të punësuar, Kosova ka shkallën më të lartë të vdekjeve në rajon. Si pasojë e aksidenteve, 6.5 vdekje ndodhin në 100 mijë punonjës, përdërsa në vendet e BE-së, mesatarja e fataliteteve në punë është 1.83. Ky është një shqetësim me të cilin institucione të caktuara, konkretisht Inspektorati i Punës duhet të merret seriozisht.

Bizneset janë duke i shfrytëzuar dy mangësi në shoqërinë tonë që i detyrojnë punëtorët të punojnë pa kushte të duhura të punës: neglizhencën e shtetit dhe nivelin e lartë të papunësisë. Punëtori kosovar nuk është në gjendje të negociojë kontratën e tij të punës. Ai nuk është mjaftueshëm i fuqishëm për të kërkuar të drejtat e tij që ligjet në fuqi ia garantojnë. Mungesa e qoftë një sindikate të vetme që do të përfaqësonte punëtorët karshi punëdhënësve, e rëndon më tej situatën.



Nga studimet e mëhershme të IKS – “Vdekjet e heshtura”, mungesa e kushteve minimale të sigurisë në punë, del të jetë faktori kryesor i humbjes së jetëve të punëtorëve. Sipas të njëjtit studim, këto raste pavarësisht se janë tragjedi të mëdha, nuk marrin vëmendjen e duhur mediatike. Duke i munguar edhe kjo, atëherë edhe reagimet shoqërore ndaj këtyre rasteve tragjike janë të vakëta.



Problem tjetër në kushtet e punës janë edhe sëmundjet profesionale. Këshilli Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë, e kishte premtuar një listë të paktën preliminare të këtyre sëmundjeve, por deri më tani nuk është realizuar. Evidentimi i tyre është i një rëndësie të veçantë, për shkak se do të krijonte mundësi të vlerësimit më të lehtë të

kushteve të punës në sektorë përkatës. Derisa kjo të mos bëhet, vështirësitë do të vazhdojnë të bëhen edhe më të mëdha nga ç'janë aktualisht.

Siguria dhe shëndeti në punë padyshim që do të mbesë në këto nivele alarmante derisa institucionet përkatëse të mos jenë në nivel të detyrës. Përgjatë tri viteve të fundit, legjislacioni i sigurisë dhe shëndetit në punë është plotësuar me adaptimin e 17 direktivave të BE-së. Sido që të jetë, zbatimi i tyre dhe efektet pozitive në teren janë vërejtur shumë pak. Inspektorati i Punës si hallka e parë institucionale që drejtpërdrejtë merret me inspektimin e kushteve të punës, duhet ta reformojë veten për të ngritur efikasitetin. Së dyti, prokuroria duhet t'i kushtojë vëmendje ndjekjes penale ndaj të gjithë atyre punëdhënësve, të cilët nuk krijojnë kushtet e nevojshme për punë të sigurtë. Së fundi, gjykatat

duhet të aplikojnë masa ndëshkuese, jo vetëm për të vendosur drejtësi në raste të caktuara, por që ato të shërbejnë si forma të disiplinimit të të gjithë atyre që të drejtat e punëtorëve i nëpërkëmbin. Sigurisht që problemet janë të shumëllojshme, të atilla si edhe mungesa e bashkëpunimit mes institucioneve përkatëse.

Inspektorati i Punës si dhe ai i Minierave dhe Mineraleve, i cili është përgjegjës për inspektimin e kushteve në vendpunishte ku nxirren minerale, nuk bashkëpunojnë mes vete, aq më pak në bashkërendimin e aktiviteteve të përbashkëta.



Gratë dhe Punësimi

Përcaktimi kushtetues se të gjithë qytetarët e Kosovës janë të barabartë, në mundësitë që kanë ata për të gjetur punë, në realitet del të jetë ndryshe. Gratë janë dukshëm të diskriminuara në tregun e punës ku më pak se 12% e të gjitha grave kosovare janë të punësuar. Ky tregues është më i ulët në nivel botëror. Përqindja e ulët e grave në marrëdhënie pune, nuk e bënë këtë thjeshtë një problem shoqëror, por e paraqet gruan, e cila është gjysma e popullsisë së vendit, si një komunitet të marxhinalizuar.

Në vitin 2019, Qeveria e Kosovës ka miratuar një ligj për paga, i cili i ka kushtuar vëmendje vetëm sektorit publik dhe aspak atij privat, e sidomos grave. Si shumë nga reformat e inicuar gjatë kësaj qeverisjeje, edhe ligji mbi pagat është hartuar për efekt zgjedhor, e të gjitha lëvizjet rreth tij vazhdojnë të jenë politike. Me politika të tilla, krijimi i pabarazive shoqërore rritet, gjë që lehtësisht mund të çojë në kriza tjera të pa menaxhueshme për kapacitetet institucionale të Kosovës.

Përderisa shtatzënia gjithandej nëpër botë shihet si një element me rëndësi shoqërore, në Kosovë ajo bëhet problem për gratë në marrëdhënie pune. Ligji i Punës (Nr. 03/L-212) i njeh çdo gruaje të drejtën e pushimit të lehonisë për plot 12 muaj. Në Kosovë, ka raste të panumërta kur në momentin që punëdhënësi ka kuptuar se punonjësja është shtatzënë, e kanë larguar nga puna. Për ilustrim, në një prej mediumeve, konkretisht një gazete, është larguar pas 3 vjetësh punë gazetarja me arsyetimin si e "pa aftë për punë".

IKS ka bërë disa studime të cilat e paraqesin pozitën e gruas në shoqëri tejet të vështirë, si rezultat i drejtpërdrejtë të mundësive të vogla për t'u përfshirë në tregun e punës. Vetëm 28% e grave të cilat janë në marrëdhënie pune, kanë deklaruar se punojnë në sektorin privat. 66% e grave të pa puna kanë deklaruar se pranojnë të punojnë me një pagë më të vogël se 250 euro për muaj. Një pagë e tillë, nuk plotëson as nevojat elementare të një individi, e aq më pak të një familje standarde me pesë anëtarë. Kriteri i kërkimit të punës nga gratë është ulur nën minimum, vetëm për të gjetur punë. Madje ato shkojnë edhe më tej, bien poshtë kriterëve minimale të obliguara nga ligji për kushtet që duhet një punëdhënësi t'i plotësojë punëtorit. Sipas gjithë kësaj, del se kushtet ekonomike kanë bërë që njerëzit të bëjnë kompromis me të drejtat e tyre që ligjet në fuqi ia garantojnë, vetëm e vetëm për të siguruar një minimum të mirëqenies sociale.

Një tjetër problem që paraqitet te punësimi i grave është mundësia e vogël e tyre për të marrë kredi në banka që të krijojnë vendin e tyre të punës. Studime tjera dëshmojnë se 3% e huadhëniesve të bankave shkojnë për gratë. Fakti që ato shumë më pak janë titullarë të pronave, i bënë partnere jo të besueshëm dhe për bankat komerciale.

Për të përmirësuar situatën, është e domosdoshme të angazhohen një mori faktorësh shoqëror, ku në mesin e tyre, më të rëndësishmit janë; qeveria, bizneset private dhe shoqëria civile. Kësaj të fundit i takon detyra për të rritur presionin publik që do të vetëdijësonte si qeverinë ashtu edhe bizneset private që diskriminimi i gruas në punësim përbënë një padrejtësi shoqërore, pasojat e të cilës mund të jenë afatgjata.



www.d4d-ks.org

Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Leja Prindërore për Barazi Gjinore

(Ky shkrim shfrytëzon të dhëna nga punimi: *Ndryshimi i Paradigmës – Barazi përmes lejes prindërore, Ajete Kerqeli, Instituti Demokraci për Zhvillim, 2017*)

Leja prindërore ose leja familjare është përfitim i punonjësve në dispozicion pothuajse në të gjitha vendet e botës. Ajo ka qenë në dispozicion si një e drejtë ligjore ose program qeveritar për shumë vite, në një formë ose në një tjetër në shumë shtete.

SHTETI	LEJE PRINDËRORE E PAGUAR
KOSOVA	JO
SHQIPËRIA	PO
MAQEDONIA E VERIUT	JO
MALI I ZI	PO
KROACIA	PO
GREQIA	PO
ROMANIA	PO
HUNGARIA	PO
AUSTRIA	PO
ITALIA	PO
ZVICRA	PO
ÇEKIA	PO
SLLOVAKIA	PO
NORVEGJIA	PO
POLONIA	PO
GJERMANIA	PO
FRANCA	PO
BELGIKA	PO
HOLANDA	PO
DANMARKA	PO
FINLANDA	PO
LITUANIA	PO
LETONIA	PO
ESTONIA	PO
BULLGARIA	PO
SPANJA	PO
PORTUGALIA	PO
SUEDIA	PO

Kjo infografikë është zhvilluar si pjesë e projektit "Leja prindërore për barazi gjinore", që implementohet nga Demokraci për zhvillim, financohet nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme dhe mbështetet nga Qeveria Suedeze.



Marrja e lejes prindërore nga baballarët është shumë rëndësishme. Kjo konsiderohet si koha kur baballarët mund të zhvillojnë marrëdhënie më të mira me fëmijët e tyre dhe të mësojnë aftësi prindërore. Koha e kaluar për t'u kujdesur vetëm për fëmijët është ajo që i ndihmon burrat të bëhen baballarë më të mirë. Ekzistojnë gjithashtu prova që pjesëmarrja e tyre në jetën e fëmijëve të tyre që nga lindja ka rezultate pozitive dhe të qëndrueshme për zhvillimin e fëmijëve, siç janë përmirësimi i aftësive njohëse dhe emocionale, si dhe shëndetit fizik.




www.d4d-ks.org

Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Përfshirja më e madhe e baballarëve në kujdesin e fëmijëve ka përfitime të mëdha edhe për gratë. Mirënjohja nga punëdhënësit që nënat dhe baballarët kanë përgjegjësi të barabarta në kujdesin ndaj fëmijëve të porsa-lindur mund të ndikojë shumë në përmirësimin e barazisë gjinore në tregun e punës. Ndarja më e barabartë e përgjegjësisë profesionale dhe familjare, nga ana tjetër, ka ndikim pozitiv në ekuilibrin punë-jetë në familje dhe karrierë. Leja e paguar gjithashtu ka efekt pozitiv në bizneset pasi promovon mbajtjen e punonjësve, rrit moralin dhe produktivitetin dhe zvogëlon mungesën dhe qarkullimin e stafit.

Sidoqoftë, kur baballarët nuk marrin leje prindërore, ajo forcon rolet gjinore tradicionale të grave si kujdestare kryesore të fëmijëve dhe rolin e baballarëve si kryesorë në sigurimin e të ardhurave për familje. Për të ndryshuar këtë qëndrim shoqëror, janë të domosdoshme politikat familjare që i lejojnë të dy prindërit të ndajnë kohë në mënyrë të barabartë në kryerjen e përgjegjësisë prindërore dhe profesionale.



Kjo infografikë është zhvilluar si pjesë e projektit "Leja prindërore për barazi gjinore", që implementohet nga Demokraci për zhvillim, financohet nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme dhe mbështetet nga Qeveria Suedeze.






www.d4d-ks.org

Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Në Kosovë, dy të tretat e popullsisë janë në moshë punë (15-66 vjeç). Sidoqoftë, pjesëmarrja e grave në tregun e punës në Kosovë vlerësohet të jetë më e ulta në Evropë. Një në pesë (18.6%) gra në moshë pune janë aktive në tregun e punës, krahasuar me rreth tre në pesë (58.3%) e burrave në moshë pune. Ndërsa, midis atyre që janë aktivë në forcën punëtore, papunësia është më e lartë për gratë sesa për burrat (31.8% krahasuar me 26.2%). Shkalla e punësimit tek gratë në moshë pune është vetëm 12.7%, krahasuar me 43.0% për burra.

Hulumtimet tregojnë se gratë përballen me diskriminim në procesin e punësimit, veçanërisht nëse janë shtatzënë ose dëshirojnë të kenë fëmijë. Në një studim të të bërë nga D4D, 59.8% e të anketuarve besojnë se ka diskriminim ndaj grave në procesin e marrjes në punë. 53.2% e burrave dhe grave mendojnë se një nga arsyet pse gruaja nuk kërkon punë, janë përgjegjësitë që ajo ka të bëjë me kujdesin për fëmijën dhe të moshuarit.

Duke pasur parasysh që sistemi aktual i lejes së lindjes të nënave në Kosovë dhe modeli i ri i propozuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nuk kujdesen për kërkesat e popullatës, D4D ka realizuar një studim për të vlerësuar gatishmërinë e burrave dhe grave për të marrë leje prindërore. Hulumtimet në mënyrë të vazhdueshme tregojnë se baballarët dëshirojnë të kalojnë më shumë kohë me të porsalindurit, por presioni shoqëror për t'u pajtuar me rolet tradicionale gjinore dhe ndikimin e perceptuar në karrierën e tyre, do të thotë që baballarët thjesht nuk kanë stimuj të mjaftueshëm për të marrë më shumë leje. Hulumtimi i fundit i realizuar nga D4D në Mars 2018 tregon se 30.6% e burrave në Kosovë do të merrnin lejen prindërore deri në 3 muaj nëse paguhet deri në 70% të pagës bazë të tyre, ndërsa 18% e burrave do të merrnin të njëjtin kompensim deri në 6 muaj. Prej vitit 2017, kur Ministria e Punës dhe Mireqenies Sociale kanë filluar procesin e ndryshimeve legislative sa i përket rregullimi të çështjes së lejes prindërore dhe lejes së lindjes, Instituti D4D ka avokuar për dispozita ligjore që janë në drejtim të ekuilibrit më të madh në jetë dhe punë në familje, duke u munduar të krijojnë parakushte që baballarët kosovarë të kenë të drejtën për t'u përfshirë aktivisht në kujdesin ndaj fëmijevë – duke u munduar të rrisë ndërgjegjësimin qytetar se kujdesi për fëmijë nuk është përgjegjësi vetëm e nënave.



Kjo infografikë është zhvilluar si pjesë e projektit "Leja prindërore për barazi gjinore", që implementohet nga Demokraci për zhvillim, financohet nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme dhe mbështetet nga Qeveria Suedoze.





www.d4d-ks.org

Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

Për të kujdesur për kërkesat e popullatës dhe për të përafuar modelin bazuar në provat aktuale shkencore dhe psikologjike në lidhje me ndikimin e lejes prindërore, D4D në konsultim me një gamë të gjerë të palëve të interesit përgjatë viteve 2017-2018 ka propozuar një skemë të lejes prindërore bazuar në minimumin e kërkesave të direktivës së BE-së (Direktiva 2010/18 / BE) ku katër muaj i janë dhënë nënës si leje lindjeje dhe një muaj i ndahet babait si leje atësie. Për më tepër, familja merr 8 muaj leje prindërore, nga të cilat katër muaj janë ndarë për nënën dhe katër muaj i ndahen babait si e drejtë individuale. Një model i tillë mund të ndihmojë në forcimin e barazisë gjinore në kuadrin e roleve të punës, pagës dhe pjesëmarrjes në vendin e punës.

Politikat duhet të mbështesin familjet me prindër që punojnë në tre mënyra: (i) duke siguruar që prindërit kanë të drejtë të marrin leje prindërore për t'u kujdesur për fëmijët e tyre; (ii) sigurimin ose përkrahjen e përkujdesjes për fëmijët nga të dy prindërit; dhe (iii) ofrimin e mbështetjes financiare për kostot e lindjes së fëmijëve. D4D avokon për ndryshimin e propozuar në sistemin aktual dhe modelin e propozuar, përmes modelit i cili garanton lejen e lindjes për nënat, lejen e atësisë për baballratë dhe një ndarje jo të transferueshme të lejes prindërore dhe si për nënën ashtu edhe për babanë, krahas një ndarje të paguar dhe të papaguar. Qëllmi kryesor i rekomandimeve është të zvogëlojë çekuilibrin gjinor në tregun e punës dhe shoqëri, të shkaktuar duke ofruar vetëm leje lindjeje për nënat. Politikat e tilla, mund të krijojnë efekt të vlefshëm për shoqërinë kosovare. Duke ofruar leje prindërore të paguar babait, në fakt duke ekuilibruar lejen prindërore midis prindërve, thyhen stereotipat gjinore në shoqëri për rolet tradicionale gjinore, të mvëshura ndaj grave si kujdestare primare të fëmijëve.



IKS-i përdor letër
të ricikluar

Rreth IKS-it:

Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) është institut kërkimor i pavarur, jo fitimprurës, që fokusohet në hulumtime empirike dhe analiza të zhvillimeve socio-ekonomike në Kosovë. IKS u themelua në vitin 2004 në përgjigje të nevojës dhe kërkesës për analiza të pavarura e cilësore të çështjeve me rëndësi në kuadër të promovimit të stabilitetit dhe prosperitetit në Kosovë. Hulumtimet e saj inovative dhe të politikave përkatëse kanë për synim inicimin e debateve për temat me rëndësi për të ardhmen e Kosovës, gjenerimin e një konsensusi kombëtar dhe arritjen e një niveli më të lartë bashkërendimi e pajtimi për vendimet politike, si dhe inspirimin e një maturimi politik vendor për marrjen dhe gjetjen e vendimeve të duhura. IKS-i synon të mbështesë në vazhdimësi burrat dhe gratë duke rritur ndërgjegjësimin e tyre për çështjet kyçe politike, legislative dhe debatet që mund të kenë ndikim të thellë për ata vetë, familjet dhe komunitetin e tyre. Ne punojmë me ngulm që të ofrojmë të dhëna empirike dhe hulumtime për të lehtësuar pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e reformave të politik bërjes, me theks të veçantë në qeverisje të mirë, drejtësi dhe drejtësi sociale, të drejtat e njeriut, trashëgimi kulturore dhe integrimet Evropiane.



Sylejman Vokshi
50/2, Prishtinë



+383 38 260 600



IKSweb.org



Iniciativa Kosovare për
Stabilitet - IKS

